

KOMUNA E JUNIKUT

NJOFTIM PER INFORMATA SHTESE

ose

PERMIRESIM I GABIMIT

Sipas Nenit 53 të Ligjit Nr. Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92

☐ Punë

☒ Furnizim

☐ Shërbime

[Përkujtese: Nëse ndonjë përmirësim i gabimit ose informacion shtese shpije ne një ndryshim rrënjësor të kushteve të parashikuara në njoftimin origjinal te kontratës me një influencë mbi parimin e trajtimit të barabartë dhe në objektivin e prokurimit konkurrues, do të jetë e nevojshme zgjatja e afateve fillimisht te parapara]

Data e përgatitjes te këtij njoftimi: 30.06.2026

Nr i Prokurimit	636-26-5243-1-2-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KOMUNA E JUNIKUT		
Adresa Postare: Rr.Luan Haradinaj		
Qyteti: Junik	Kodi postar: 51050	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Imer Gjota		Telefoni: +383 46106358
Email: imer.gjota@rks-gov.net prokurimi-junik@rks-gov.net		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		https://junik.rks-gov.net/en/

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: (ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)
Furnizimi me lëndë djegëse me pelet dhe dru për IEA

II.1.2) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës (ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)

Furnizimi me lëndë djegëse me pelet dhe dru për IEA

II.1.3) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): (ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)

02100000-5

NENI III: PROCEDURA

III.1) LLOJI I PROCEDURËS

III.1.1) Lloji i procedurës (ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)

☒ **E hapur**

☐ **E kufizuar**

☐ **Konkurruese me negociata**

☐ **Kuotim i çmimit**

III.2) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

III.2.1) Data e publikimit të njoftimit origjinal të kontratës:

NENI IV: INFORMACIONET PLOTËSUESE

IV.1) KY NJOFTIM PERFSHINE

Përmirësim ☒

Informata shtesë ☐

Njoftim për kontratë ☒

Njoftim për dhënie kontratë ☐

IV.2) INFORMACIONI QE DUHET TE PERMIRESOHER OSE TE SHTOHET (nëse aplikohet; te specifikohet vendi i tekstit ose datat te cilat duhet te përmirësohen apo te shtohen, ju lutem gjithmonë ofroni nenet përkatëse & numrin e paragrafit te njoftimit origjinal)

IV.2.1) Modifikimi i informatave ☒
origjinale të dorëzuara nga Autoriteti Kontraktues

Publikimi në webfaqen e KRPP-së ☐
nuk është në përputhje me informatat origjinale të dorëzuara nga Autoriteti Kontraktues

Të dyja ☐

IV.2.2) Në njoftimin origjinal ☐

Në dokumentet e tenderit ☐

Të dyja ☒

IV.2.3) Teksti i cili duhet të përmirësohet/shtohet në njoftimin origjinal (nëse aplikohet)

Vendi i tekstit i cili duhet të modifikohet:

Në vend të:

Është :

Informata të tjera shtesë:		Të nderuar Operatorë Ekonomikë, Ju njoftojmë se Autoriteti Kontraktues ka plotësuar dhe publikuar Formularin për Gabime Teknike, për shkak se gjatë publikimit të procedurës së prokurimit janë evidentuar disa gabime teknike në sistem. Ju informojmë se Dosja e Tenderit është e plotë dhe e rregullt, mirëpo për shkak të një problemi teknik në sistem, jo të gjitha informatat e përfshira në Dosjen e Tenderit janë bartur në Njoftimin për Kontratë. Për të shmangur çdo paqartësi dhe për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë Operatorët Ekonomikë, ju njoftojmë se të dhënat e sakta janë si në vijim Periudha e vlefshmërisë së tenderit 60 (gjashtëdhjetë) ditë. Afati për kërkimin e sqarimeve lidhur me Dosjen e Tenderit deri më 15.07.2026. Ju lutemi që gjatë përgatitjes së ofertës suaj t'u referoheni të dhënave të korrigjuara të publikuara përmes Formularit për Gabime Teknike, të cilat janë pjesë përbërëse e dokumentacionit të procedurës së prokurimit. Ju falënderojmë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj. Me respekt, Autoriteti Kontraktues
Kërkesat e përshtatshmërisë		Kërkesa 1.Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik.Operatori Ekonomik duhet të jetë i regjistruar në ARBK dhe të ketë aktivitet primar ose sekondar për tregtimin ose furnizimin me lëndë djegëse me baze druri, Kërkesa 1. Kopja e certifikatës së

Kërkesat e përshtatshmërisë	regjistrimit të biznesit Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr.04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092. b) Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. c) Vërtetim nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike - Një dokument të lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush “Kërkesat e përshtatshmërisë. d) Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme., Dëshmia a) Deklarata nën betim nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit – Aneksi 2. b) Vërtetim nga Administrata Tatimore- kopje c) Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike, kopje - Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërbllim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. d) Vërtetimin
------------------------------------	---

	nga Gjykata Themelore kopje - Kërkohe origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.
Kërkesat e përshtatshmërisë	Kërkesa 3. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të jenë deklarues të TVSH- së., Dëshmia 3. Si dëshmi operatori ekonomik duhet të dorëzojë Kopjen e certifikates se TVSH-së.
Kapaciteti ekonomik dhe financiar	Kerkesa 4. Operatori Ekonomik duhet të ketë qarkullim vjetor në tri (3) vitet e fundit në vlerë minimale prej 36,015.00 € ose (1.5 herë vlera e parashikuar e kontratës)., Dëshmia.4 Pasqyrat financiare ose vërtetim nga ATK.
Kapaciteti ekonomik dhe financiar	Kerkesa 5.Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë qasje në mjete financiare ose linjë kreditore në vlerë minimale se paku prej 15,000.00 €, Dëshmia Vërtetim nga banka ose kontratë valide për linjë kreditore.
Kapaciteti teknik dhe profesional	Kerkesa 6. Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar me sukses së paku 2 kontrata të ngjashme gjatë tri (3) viteve të fundit., Dëshmia Lista e kontratave, kopjet e kontratave dhe referencat ose certifikatat e pranimi te sukseshme
Kapaciteti teknik dhe profesional	Kerkesa 7. Operatori Ekonomik duhet të posedojë së paku 2 kamionë për transportin e lëndëve djegëse., Dëshmia Libreza e qarkullimit dhe regjistrimi valid ose kontratë leasing qiraje.
Kapaciteti teknik dhe profesional	Kërkesa 8.Operatori Ekonomik duhet të posedojë së paku 1 autongarkues (Forklift Piruner)., Dëshmia Dokument pronësie ose kontratë leasing qiraje.

Kapaciteti teknik dhe profesional	Kerkesa 9. Operatori Ekonomik duhet të disponojë depo me sipërfaqe minimale prej 500 m2, Dëshmia Certifikatë pronësie ose kontratë qiraje valide për prokurimin në fjalë
Kapaciteti teknik dhe profesional	Kerkesa 10. Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon stok të mjaftueshëm të lëndëve djegëse për furnizim të rregullt gjatë realizimit të kontratës., Dëshmia Deklaratë mbi gjendjen e stokut ose dokumente përcjellëse apo fotografi për stokun.
Kapaciteti teknik dhe profesional	Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë 1 mostër të peletit A1 me bazë druri (15 kg) në paketim origjinal para afatit të dorëzimit të ofertave,apo procesverbalit të hapjes së paku 1 orë më herët, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën e verifikimit dhe testimit laboratorik të mostrës, në rast nevojës së autoritetit kontraktues

----- (Shto nenin IV.2.3 sa here që keni nevojë) -----